

INSTITUTI I STUDIMEVE PEDAGOGJIKE

PROGRAMI I LËNDËS

SË EDUKIMIT FIGURATIV

KLASA II

CIKLI FILLOR I SHKOLLËS 9-VJEÇARE

TIRANË, 2004

HYRJE

Programi i edukimit figurativ për klasën e dytë realizon atë që duhet të njohin dhe të bëjnë nxënësit në edukimin figurativ, duke u mbështetur në psikologjinë e moshës. Ai ka në qendër përvojën e nxënësit, të cilën kërkon ta njohë, ta zhvillojë, ta pasurojë e ta çojë më përpara, duke e ndërthurur atë në mënyrë të natyrshme me historinë, kulturën e artin jo vetëm të fshatit apo qytetit ku jeton e mëson fëmija, por edhe me atë të krahinave të tjera të e të vendeve të ndryshme të botës, që ai ta ndjejë veten pjesë të së tërës dhe të botës ku jeton.

Edukimi figurativ i krijon mundësi nxënësit të fitojë njohuri dhe t'i interpretojë ato në mënyrë origjinale. Ky program do ta ndihmojë nxënësin të zhvillojë aftësitë e tij për të përcaktuar, për të përmirësuar dhe për të zgjidhur problemet e tij estetike që i dalin, për të qenë sa më i suksesshëm në jetë.

QËLLIMI

Programi i edukimit figurativ në klasën e dytë, ka për qëllim të formimin artistik të nxënësit për të kuptuar artin figurativ dhe për t'u shprehur nëpërmjet tij.

Objektivat e përgjithshëm

Në fund të klasës së dytë nxënësi duhet të jetë i aftë:

-Të krijojë punë të ndryshme arti, në 2–3 përmasa që komunikojnë ide, mendime, ndjenja, përvoja, për një qëllim të caktuar;

-Të përdorë elementet dhe parimet e artit (ngjyrat, vijat, formën, hapësirën, sipërfaqet) në mënyrë të përshtatshme për këtë nivel;

-Të përshkruajë si elemente të ndryshme të artit (të ndeshura në vepra arti) që lidhen me njohuritë dhe përvojat e tyre;

-Të përdorë një fjalor dhe terminologji artistike, të thjeshtë për këtë nivel.

Përmbajtja e programit

Programi i edukimit figurativ synon të realizojë formimin artistik të personalitetit të nxënësit duke e pajisur atë me:

1. *Njohuri* - a) për bazën materiale, si: shkumsat, lapsat, pastelat, argjilin, llojet e letrave, copa tekstili të ndryshme, fillin e leshit, kuvaristos, akrilikon; për proceset e punës si: përshkallëzimi në thurjen e një motivi, krijimin e një skulpture, përdorimin e ngjyrave me nuanca të hapura apo të errta etj.; teknikat për të realizuar një punë artistike, si: kolazhet, pikëzimet piktura, tekstile (zbatime të thjeshta me basme), stampime (me objekte të thjeshta rrethore);

b) për elementet e parimet e artit, si: njohuri për ngjyrat e para e të dyta, zgjerimin e njohurive për llojet e vijave, format 2-3-përmasore, barazpesha, theksi, lëvizja, uniteti, kontrasti;

c) përdorimin e simboleve e tematikave të larmishme nga jeta e tyre e mjedisi;

ç) për historinë e kulturën e artit pamor të vendit e botërore;

d) për analizën, vlerësimin, interpretimin e një punimi artistik të vetin, të shokut apo të një vepre të caktuar arti, si dhe zhvillimin e një fjalori të caktuar artistik;

dh) për rolin e artit dhe të artistit në komunitet e në jetën e përditshme.

2. *Aftësi* - a) për të dalluar dhe për të përdorur ngjyrat e para e të dyta, marrëdhëniet në mes rrethit të ngjyrave, përcaktimin e ngjyrave të ftohta e të ngrohta, përcaktimin e sipërfaqeve;

b) për identifikimin e ideve dhe të simboleve, gjuhën emocionale në një krijim artistik;

c) për përshkrimin dhe interpretimin e karakteristikave të një vepre arti dhe të karakterit të tyre historik;

ç) për të analizuar, për të zbatuar dhe për të vlerësuar në bazë të njohurive të marra punën e tyre e të shokut apo një vepre arti;

d) për bashkëpunim, për të punuar në grup, për të dëgjuar mendimin e shokut, për të krijuar miqësira e për të pakësuar mosmarrveshjet;

dh) për ta gjetur të bukurën në orenditë shtëpiake, në rregullimin e mobiljeve, në arkitekturën e ndërtesave e mjedisit;

e) për të përdorur imagjinatën, fantazinë, ëndrrat në veprimtarinë krijuese.

3. *Shkathtësi* - a) për përdorimin e bazës materiale, si: lapsi, goma, gërshëra, peneli, bojërat, pastelën etj.;

b) për përdorimin e fjalorit artistik në përcaktimin e elementeve të artit, të karakteristikave të tyre, përshkrimin e veprave artistike;

c) për komunikimin nëpërmjet simboleve.

4. *Qëndrime* - a) për të qenë të pavarur në vlerësime e në dhënien e mendimeve;

b) për të respektuar mendimin e tjetrit për atë që kanë menduar të transmetojnë me veprën e tyre;

c) për të marrë përgjegjësi për punën që bëjnë, për përgjigjet që japin, për lidhjet që krijojnë.

5. *Vlera* - a) respektimi i lirive e të drejtave të njeriut në këtë fushë, si: përzgjedhja e materialeve, elementeve e parimeve për të shprehur idetë, mendimet e ndjenjat e tyre;

b) respektimi i traditave e zakoneve;

c) realizimi i detyrave e përgjegjësive për të përfunduar një detyrë;

ç) për mirëmbajtjen e mjeteve, krijimin e dosjes.

STRUKTURA E PROGRAMIT

Përmbajtja e programit të edukimit figurativ është ndërtuar mbi 6 linja, të cilat krijojnë një bazë të fuqishme për të arritur objektivat kryesorë të të mësuarit.

1. Baza materiale, procese, teknika

2. Elemente dhe parime

3. Tematika

4. Historia dhe kultura

5. Analiza, interpretimi, vlerësimi

6. Lidhjet ndërlëndore me jetën e mjedisin.

PROGRAMI ANALITIK PËR KLASËN E DYTË

35 javë mësimi x 1 orë në javë 35 orë vjetore

1. Baza materiale, procese e teknika	4 orë
2. Elemente dhe parime	17 orë
3. Tematika	3 orë
4. Historia dhe kultura	4 orë
5. Analiza, interpretimi, vlerësimi	3 orë
6. Lidhjet ndërlëndore me jetën	3 orë
7. Orë në dispozicion	1 orë

Linja I. Baza materiale, procese, teknika 4 orë

Nxënësi duhet të njohë, të përzgjedhë dhe të përdorë materiale, mjete, procese e teknika . Ai:

- Përdor materiale të ndryshme dhe të diskutojë efektet që realizojnë ato në një punim artistik:
 - përdorimi i ngjyrave të dyta në materiale të ndryshme (*si letër, basme, karton, etj., - kolazh*);
 - përcaktimi i efekteve të ndryshme, p.sh., shkumsat, tempera, akuarelet, lapustilat etj., që japin këto materiale, duke vepruar me ngjyrat e dyta;
 - përshkrimi i tyre përdorimeve në një vepër arti të një artisti të caktuar për dhënien e një emocioni;
 - përdorimi i mjeteve, si: shkumsat me ngjyra, lapsa, temperat, akuarelat, pastelat, furçat për të krijuar një vepër arti, në teknika të ndryshme;
- Përdor teknikat:
 - Krijim pikturë*: ngjyrosja me sungjer, sitë ose spraj, përzierja e ngjyrave të para me të dytat;
 - Vizatim*: perspektiva (vendosja e trupave afër – larg);
 - Skulpturë*: krijimi i maskave, përdorimi i letrës për mbushje të objekteve artistik;
 - Tekstil*: thurje sipas vijës së drejtë e të lakuar (qëndisje në thes me fill të trashë kuvaristo), zbatim me tekstile (peisazh);
 - Stampime*: stampime me materiale rrethanore (lapsa, pirun).
 - Dizenjo*: kolazh, gdhendje.
- Përdor materiale: lapsa, pastela, shkumsa, akuarele, letër me ngjyra, letër vizatimi, kartone, letër e zakonshme, copa tekstili, fije të trashësive të ndryshme;
- Përdor mjete të ndryshme, si: penela, enë për mbajtjen e ujit, gërshërë, gjilpërë etj.;

Linja II. Elemente dhe parime

17 orë

Nxënësi duhet të njohë e të përdorë elementet e parimet e artit në punimin e tij. Ai duhet të njohë:

Vijat:

- shumëllojshmëri vijash të krijuara nga materiale të ndryshme, si: pena, peneli, lapsi, pastela, qymyri, shkumësi (e përkulur, e trashë, e hollë) – (*vizatimi i një peisazhi, diskutimi dhe vlerësimi i efekteve të vijave sipas llojit në përfundim të punimit*).

Format 2 përmasore:

- format organike gjenden në natyrë dhe format gjeometrike gjenden në format e krijuara nga njeriu – (*kolazh me forma gjeometrike dhe organike të prera*).

Format 3 përmasore:

- Format 3 përmasore kanë: gjatësi, gjerësi dhe lartësi;
- trupat me 3 përmasa përmbajnë edhe figurat – (*krijimi i një trupi me 3 përmasa me letër, ndërtimi i një shtëpie*).

Sipërfaqet:

-Përcaktimi i sipërfaqes së duhur ndihmon në krijimin e një interesi të veçantë në art përmes dy mënyrave: a) duke e prekur, b) nga vëzhgimi i drejtpërdrejtë;
(*Krijimi i një sipërfaqeje, duke përdorur laps e letër ose ngjyra uji*)
(*Vizatim i lëkurës, gëzofit të një kafshe*)
-Vizitë në një punishte tekstilësh ose tezgjah artizanal;

Ngjyrat:

- ngjyrat e ngrohta e të ftohta, për të shprehur një gjendje të caktuar shpirtërore;
- harmonizimi i ngjyrave të para dhe përdorimi i tyre për të dhënë një pamje të caktuar të stinës – (*peisazh nga vjeshta, pranvera, etj*).

Hapësira:

- krijimi i thellësisë në veprat e artit nga vendosja e njëpasnjëshme, shtresat;
- përdorimi i mbivendosjes së objekteve për të krijuar nxënësit një punim artistik – (*krijim – fëmijët në rresht*).

Barazpesha:

- barazpesha krijon qëndrueshmëri, ku secila pjesë e veprës nuk është më e fuqishme se tjetra; barazpesha mund të krijohet nga përdorimi i simetrisë; simetria gjendet në objektet natyrore dhe të krijuar nga njeriu – (*krijimi i simetrisë boshtore me forma me letra*).

Theksi:

- Vendosja në qendër të pikturës e objektit më të rëndësishëm;
- përcaktimi i pikës më të rëndësishme në riprodhimin e një pikturë për shembull: ngjyrat, masa, forma.

Lëvizja:

- mbivendosja e formave nënkupton lëvizjen brenda veprës së artit - *(kompozimi me mbivendosje të thjeshta për të krijuar lëvizjen).*

Kontrasti:

- element grafik që fuqizon veprimin emocional;
- kontrasti në ndriçim, masa dhe ngjyra – *(krijim duke përdorur kontrastin e ngjyrave).*

Harmonia:

- Harmonia është përsëritja e një elementi për të krijuar të tërë (ritmi);
- Përcaktimi i ritmit në natyrë apo në vepër e artit nga përsëritja e një modeli - *(krijimi i një pune artistike ku të përsëritet një motiv i thjeshtë (qilime me motive popullor));*

Linja III. Tematika

3 orë

Nxënësi duhet të shqyrtojë, të përzgjedhë dhe të përdorë shumëllojshmëri temash, simbolesh, idesh nga jeta e tij. Ai:

- Kijon një revistë sipas imagjinatës, shijeve dhe interesave të tij - *(në të mund të ngjiten foto, piktura, mesazhe të ndryshme të marra nga revistat, gazetat);*
- Përdor simbolet për të paraqitur harta, planimetri - *(vizatimi i simboleve të thjeshta, të qarkullimit rrugor ose një hartë të thjeshtë të shkollës apo lagjes ku jetojnë);*
- Vëzhgon dhe të diskuton një vepër arti, ku artisti të jetë frymëzuar nga një ngjarje jetësore (“Dasma” nga Kolë Idromeno).

Linja IV. Historia dhe kultura

4 orë

Nxënësi të kuptojë edukimin figurativ në lidhje me historinë dhe kulturën. Ai:

- Përshkruan një portret, duke përcaktuar ndryshimet në kohë, përshkrimi i materialeve, përshkrimi i modes në veshje, krehje, praktikiteti i veshjeve - *(krijim me veshje të ndryshme);*
- Njih kështjellat shqiptare nëpërmjet riprodhimeve e fotografive – *(krijim duke u bazuar në imazhin e këtyre kështjellave).*
- Viziton galerinë e arteve.

Linja V. Analiza, interpretimi, vlerësimi

3 orë

Nxënësi duhet të vëzhgojë, të përshkruajë, të analizojë, të interpretojë dhe të vlerësojë punimet e tij dhe të shokut. Ai:

- diskuton në një punim llojet e vijave, karakteristikat e tyre sipas materialeve me të cilat janë vizatuar, fletë për idetë, emocionin që përcjellin ato në atë punim.
- shpjegon dhe mbron punën e tij në klasë;
- krahason dy punime artistike të fushave të duke përdorur një fjalor të thjeshtë artistik për elementet e parimet e artit - *(pikturë dhe skulpturë), por që trajtojnë të njëjtën temë, p.sh., një bust të Skënderbeut dhe një portret të tij në pikturë);*

Linja VI. Lidhja ndërlëndore me jetën dhe me mjedisin 3 orë
Nxënësi duhet të bëjë lidhjet mes arteve pamore dhe disiplinave të tjera në jetën e përditshme. Ai:

- gjen elementet e artit (vijat, ngjyrat, format) në një endje, qëndisje, në një pëlhurë tekstili etj., nga kutura të ndryshme (në qilimat shkodranë, kuksianë, korçarë etj.)
- ilustron me vizatime i një përralle, vjershe apo tregimi sipas imagjinatës së tij;
- krijon një vizatim nga vëzhgimi i drejtpërdrejtë.

METODOLOGJIA E REALIZIMIT TË PROGRAMIT

Zbatimi me sukses i programit në klasën e dytë kërkon përgatitje dhe përgjegjësi nga mësuesi, i cili të njohë, të drejtojë e të nxisë veprimtarinë e nxënësit, të njohë mirë përmbajtjen e programit, si dhe të jetë vazhdimisht i interesuar për t'u kualifikuar nëpërmjet studimit vetjak apo të drejtuar nga institucionet e specializuara, të krijojë një bazë të fuqishme materiale për t'i paraprirë një zhvillimi normal të orës së mësimit, të sqarojë më parë të gjitha çështjet e paqarta të përmbajtjes që të jetë i qartë për atë që do t'u transmetojë nxënësve. Tek zbërthimi i secilës linjë janë dhënë niveli i përvetësimit të koncepteve, teknikat, aftësitë, shprehitë, si dhe tema të mundshme për hartimin e planit tematik. Plani tematik mund të zërthehet në 6 rubrika për: tema për çdo orë, linjat, mjetet, teknikat. Për zbatimin me sukses të programit të parashikohet dhe veprimtaria në grup me nxënësit, duke përfshirë edhe nxënësit me probleme, ndërsa detyra të veçanta mund të parashikohen për nxënësit e talentuar. Për këtë, të vendosen lidhje me artisët e vendit ku është shkolla, të realizohen veprimtari, si: ekspozita me një tematikë të caktuar, të zhvillohen biseda, vizita në studiot e piktorëve etj. Nga realizimi me sukses apo jo i orës së mësimit bëhet nxitja ose frenimi i interesave të nxënësit për artin.

VLERËSIMI

Kriteret e vlerësimit janë të përcaktuara në standardet e arritjes, një dokument të cilin mësuesi ta ketë gjithmonë pranë për të qenë sa më i qartë e i saktë në shprehjet e shënimit që përdor. Metodologjia për të vlerësuar nxënësit mos të bazohet në konkurrencë, por në bazë të një diskutimi të natyrshëm për arritjet dhe për ato që nxënësi mund të realizojë më mirë. Në diskutim të marrin pjesë të gjithë nxënësit, të cilët orientohen nga mësuesi në bazë të objektivave të orës së mësimit. Diskutimi, zakonisht, bëhet në fund të orës së mësimit. Në vlerësim të merret parasysh dhe vetëvlerësimi i nxënësit, si dhe mendimi i shokut. Vlerësimi do të thotë që mësuesi të reagojë gjithmonë gjatë veprimtarisë së nxënësit. Ndërsa vlerësimi për dokumentim bëhet me grup temash për të gjithë nxënësit apo dhe në mënyrë individuale sipas kritereve që mund të vendosë shkolla.

INTEGRIMI

Nëpërmjet kësaj lënde nxënësit do të nxjerrin në pah lidhjet e kësaj fushe arti me llojet e tjera të artit, me lëndët e tjera mësimore dhe me mjedisin ku zhvillohet. Kjo lëndë tregon sa i lidhur është arti figurativ me jetën tonë të përditshme, duke u dhënë mundësinë nxënësve që të krijojnë punë të ndryshme, duke harmonizuar artin figurativ me forma të tjera të artit. Kështu, për shembull, nxënësi mund të krijojë mbasi ka dëgjuar një pjesë muzikore, mund të lidhë një datë historike me një etapë të zhvillimit të arteve figurative etj.

MJETET DHE PËRDORIMI I TYRE

Përdorimi i mjeteve në punimin artistik është i domosdoshëm për të arritur një nivel të kënaqshëm gjatë veprimtarisë mësimore. Është shumë e rëndësishme që çdo nxënës të ketë kutinë e tij të mjeteve të punës. Në pamundësi të kësaj, shkolla mund të sugjerojë për të përdorur mjetet në grup.

Mjetet më të rëndësishme janë :

Grupi i parë: shkumsa me ngjyra (tetë ngjyra), lapsa me ngjyra, gomë dhe laps i zi HB, lapustila, akuarelet, pastela.

Grupi i dytë: vinovil, letërngjitës, skoç, vizore, gërshërë.

Grupi i tretë: penela të ndryshme të cilat janë të përcaktuar në paketa të veçanta (të disa madhësive), fletore vizatimi, fletore punëdore, letër tabak, kartone me ngjyra, letër për të shkruar A₄.

Grupi i katërt: mbajtëse për dosjet e punës, mbajtëse për mjetet, enë për të mbajtur ujë për pastrimin e penelave, si dhe për krijimin e ngjyrave me tempera, akuarela.

Grupi i pestë: mjete për pastrimin, peshqirë të vegjël, kartëpeceta, gazeta.

Vendi i punës

Për të zhvilluar mësimin e edukimit figurativ, është shumë e rëndësishme që nxënësi të punojë me një dritë të plotë, në një vend të sigurtë ku t'i mbështesë mjetet e tij, në një vend të ngrohtë e pa lagështirë, të pastër. Vendi më i mirë për orën e edukimit figurativ është klasa-studio. Në pamundësi të saj, klasa të ketë kushtet e përshtatshme.